

**FORMULARI I ANKESËS PRANË AUTORITETIT/ENTIT KONTRAKTOR DHE  
KOMISIONIT TË PROKURIMIT PUBLIK**

Ankesë drejtuar: Autoriteti/Entit Kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik

**Seksioni I. Identifikimi i ankimuesit**

*Ankimuesi mund të jetë një ofertues ose ofertues i mundshëm (p.sh. individ, operator ekonomik, shoqatë, bashkim operatorësh ekonomikë)*

InfoSoft Office

Emri i plotë i ankimuesit (ju lutem shtypeni)

J62426002Q

NUIS/NIPT

Koder Kashar, Autostrada Tirane-Durres, Km 8

Adresa

Tiranë

Albania

1001

Qyteti

Shteti

Kodi Postar/Posta

0692035383

Numri i telefonit (përfshirë kodin e zonës)

Numri i faksit (përfshirë kodin e zonës)

hr@infosoftoffice.al

E-mail

administrator Frederik Prodani

Emri dhe titulli i zyrtarit të autorizuar për lëshimin e ankesës (ju lutemi shkruani)

2024/07/10

Nënshkrimi i zyrtarit të autorizuar

Data (viti/muaji/dita)

0692036179

Numri i telefonit (përfshirë kodin e zonës)

Numri i faksit (përfshirë kodin e zonës)

## Seksioni II: Informacion mbi procedurën

Numri i referencës së procedurës/Lotit

*Plotësoni numrin e referencës së kontratës në njoftimin e kontratës ose në dokumentin e tenderit.*

REF-12189-07-04-2024

---

Tipi i procedurës për ankesën

Procedure Prokurimi Publik

Tipi i ankesës

Dokumenta Tenderi

---

Plotësoni llojin e procedurës së përdorur

Open Simple

---

Autoriteti/Enti Kontraktor

*Emri i autoritetit/entit kontraktor që administron procesin e prokurimit.*

Shoqëria Rajonale Ujësjetllës Kanalizime Sarandë SH.A

---

Vlera e përlogaritur e prokurimit

*Vlera e përlogaritur e kontratës/Marrëveshjes Kuadër (shuma në shifra dhe fjalë)*

1620870

---

Objekti i kontratës/Marrëveshjes Kuadër

*Përshkrimi i shkurtër i punëve/mallrave/shërbimeve objekt kontrate/marrëveshje kuadër.*

“Blerje kancelari dhe bojëra printeri”

---

Afati i fundit për paraqitjen e ofertës

*Data (viti/muaji/dita)*

2024/07/16

---

Data e publikimit të Njoftimit të Fituesit

(Data (viti/muaji/dita) nëse është e zbatueshme)

---

Data e nënshkrimit të kontratës

(Data (viti/muaji/dita) në rastet e kërkesave për pavlefshmërinë e kontratës)

---

Tipi i kontratës

Data e zhvillimit të procedurës

Mallra

2024/07/16

---

Numri i njoftimit

Kodi CPV

CN/00129/07042024

30191000-4

---

Ankese mbi argument në KPP

---

### Seksioni III: Përshkrimi i ankesës

#### 1. Baza ligjore

(Shkelje/arsyetime ligjore, bazuar në vendime, akte, dokumente, etj.)

Ligji 162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar; VKM 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar;

---

#### 2. Objekti i ankesës

- Modifikim i dokumentave të tenderit

- Kundërshtim i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave lidhur me skualifikimin e ofertës tuaj.

(Citoni këtu arsyet e skualifikimit)

- Kundërshtim i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave lidhur me kualifikimin e ofertës të një/disa operatori/ëve ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit.

(Citoni operatorin/ët ekonomik për të cilin keni pretendime)

- Pavlefshmëri kontrate

(Citoni kontratën për të cilën kërkoni pavlefshmërinë)

- Tjetër

*(Citoni këtu objektin e ankesës që nuk përfshihet më sipër)*

### **3. Rrethanat dhe faktet** □

*Përshkruani rrethanat e faktit.* □

Më datë 05.07.2024, në sistemin elektronik të prokurimeve (app.gov.al) të Agjencisë së Prokurimit Publik, është shpallur nga autoriteti kontraktor, Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime Sarandë SH.A, “Procedure e hapur e thjeshtuar” me objekt: “Blerje kancelari dhe bojëra printeri”, me fond limit 1,620,870.30 (një milion gjashtëqind e njëzet mijë e tetëqind e shtatëdhjetë pikë tridhjetë) lekë pa TVSH, me REF-12189-07-04-2024.

I- Në njoftimin e kontratës është përcaktuar: “..Kohëzgjatja e kontratës/marrëveshjes kuadër ose afati për zbatimin e saj: 7 dite nga data e lidhjes së kontratës..”

II- Në shtojcën 5, (Formulari i Specifikimeve teknike) të DT-së janë kërkuar edhe artikujt me numrat rendore dhe me specifikimet teknike si më poshtë vijojnë:

- Nr.14 (Printer Samsung Xpress M20236)- 3 cope;

Tek specifikimet teknike të tonerave ndër të tjera janë kërkuar:

...2.Emri i kompanisë prodhuese duhet të jetë i stampuar dhe i njëjtë në paketim, cartridge (toner). Marka prodhuese të jetë në ambalazhin dhe/ose në trupin e tonerave, numrat serialë të tonerave duhet të korrespondojnë në të gjitha pjesët e trupit, në pako...

4.Në momentin e lëvrimit të mallit çdo produkt duhet të ketë të etiketuar qartë prodhuesin, modelin/numrin e printimeve/kodin e tonerit dhe nëse tonerat janë kompatibël duhet të kenë të shënuar mbi kuti që janë kompatibël për modelin e printerit..

5.Tonerat të kenë afat skadence jo më pak se një vit nga momenti i lëvrimit të mallit, (në momentin e dorëzimit të mallit tek autoritetit kontraktor, malli të shoqërohet me çertifikatën e garancisë)....

- Nr.24 (Gome fshirese e bardhe me zatore): Game universale për fshirje lapsi dhe boje. Te jete e bere nga materiali gome e bute (jo PVC), e pershtatshme per te fshire dhe njollat me te theksuara te lapsit dhe bojës. Nuk duhet te lere shenja dhe grimca ne flete pas perdorimit.;

- Nr.26 (Blloqe shenimi tavoline me ngjyra 500 flete me ngjites): Blloqe me ngjitje 75mm?5mm x 75mm?5mm me 50 flete me ngjyra te ndryshme. Letrat ngjitese sherbejne per te nxjerre ne pah mesazhet e rendesishme dhe ngjiten edhe mbi siperfaqe te veshtira. Ato mend te perdoren per te shenuar lajmerime,shenime etj- 150 cope;

- Nr. 27 (Blloqe shenimi leter stik me ngjitje 100 flete): Blloqe me ngjitje 75mm?5mm x 75mm?5mm me 50 flete me ngjyra te ndryshme. Letrat ngjitese sherbejne per te nxjerre ne pah mesazhet e rendesishme dhe ngjiten edhe mbi siperfaqe te veshtira. Ato mend te perdoren per te shenuar lajmerime,shenime etj - 180cope;

- Nr.35 (USB 16 GB): UPS- 70 cope;

- Nr.47 (Kapse me vesh (binder clips) te medha 10cope/pako): Ndërtimi i produktit të jetë i fortë dhe i qëndrueshëm që lejon të kapen shumë faqe së bashku për organizimin përfundimtar të dokumentave. Paketimi jo më pak se 12 copë- 30 pako;

- Nr.56 (Dosje konferenciale magnetike A5 zeze): Dosje konferenciale magnetike A5 zeze- 15 cope;

- Nr. 69 (Flamur me thek (institucioni) 90x145 cm): Flamur me thek (institucioni) 90x145 cm-20 cope;

II. Në shtojcën 7 (Formulari i kriterëve të përzgjedhjes/kualifikimit), të DT-së, tek Kriteret e vecanta të kualifikimit, janë përcaktuar:

2.2.1 Operatori Ekonomik duhet të paraqesë një vërtetim nga autoriteti përgjegjës për xhiron vjetore të realizuar në tre vitet e fundit ushtrimore 2021, 2022, 2023, vlera mesatare e të cilës duhet të jetë jo më e vogël se 40 % e fondit limit pa TVSH;

2.3.3 Operatori ekonomik ofertues për mallrat objekt prokurimi duhet të paraqesë katalogun/et ose fragmente të katalogut/eve ose skedat teknike të mallrave objekt prokurimi, me qëllim vërtetimin e përmbushjes së specifikimeve teknike. Katalogu ose skeda teknike duhet të përmbajë karakteristikat teknike të çdo artikulli sipas kërkesave të DST me qëllim që autoriteti kontraktor të gjykojë nëse malli i ofruar plotëson kërkesat teknike të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Për produktet e thjeshta për të cilat nuk mund të sigurohen katalogë ose skeda teknike mjafton të paraqiten mostrat sipas parashikimeve në pikën 2.3.4 dhe ky kriter do të konsiderohet i përmbushur;

2.3.4 Për artikujt e ofertuar (bojerat e printerit) duhet të paraqiten mostrat origjinale/ekuivalente, sipas specifikimeve teknike në datën dhe orën e hapjes së ofertave.

Mosdorëzimi i këtyre mostrave në kohë përbën shkak për skualifikimin e operatorit ekonomik ofertues...”

#### **4. Argumentime mbi shkeljet e pretenduara**

*Përshkruani në mënyrë koncize shkeljet e pretenduara, duke argumentuar qartë dhe saktë se përse pretendoni për paligjshmëri në veprimet e autoritetit/entit kontraktor.*

Shoqëria “Infosoft Office” SHPK, si një kompani e fushës dhe e interesuar për të ofertuar në këtë procedurë prokurimi, pasi u njoh me dokumentat e tenderit, vlerëson se, një pjesë e specifikimeve teknike dhe të kriterëve për kualifikim duhet të ndryshohen.

Për këto arsye, mbështetur në pikën 1 të nenin 110 (Afatet për ankim) të ligjit 162/2020 ”Për Prokurimin publik”i ndryshuar, ku përcaktohet se: “...1. Në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar, në rastin e ankesave për dokumentet e tenderit, operatorët ekonomikë kanë të drejtë të ankohen brenda 10 ditëve nga publikimi i njoftimit të kontratës ose publikimi i ndryshimit të kërkesave në dokumentet e tenderit. Në procedurat e prokurimit nën kufirin e lartë monetar ky afat është 7 ditë?.”, brenda afatit ligjor, paraqet ankesën e saj si më poshtë vijon:

I. Në lidhje me afatin e zbatimit të kontratës të përcaktuara në njoftimin e kontratës, e konkretisht ku është përcaktuar: “..Kohëzgjatja e kontratës/marrëveshjes kuadër ose afati për zbatimin e saj: 7 dite nga data e lidhjes se kontrates..”, paraqesim kundërshtimet tona si më poshtë:

Në procesverbalin e hartimit të dokumentave nga autoritetikontraktor nuk është dhënë asnjë argument se përse është vendosur që afati i lëvrimit të jetë vetëm 7(shtatë) dite nga lidhja e kontratës.

Autoriteti kontraktor, nuk mund të vendosë kërkesa të pa argumentuara, të pambështetura në rregullat e prokurimit public, kërkesa të cilat nuk janë në proporcion me objektin e prokurimit, pasi kërkes të tilla mund të pamundësojë pjesmarrjen e OE-ve vetëm se, AK-ja kërkon që të gjitha mallrat objekt prokurimi pra 69 llojet e artikujve të kancelarisë, përgatitja e 6 llojeve të shtypshkrimeve dhe 21 llojet e tonerave të kërkuara të furnizohen brenda 7 ditëve nga lidhja e kontratës.

Ky afat është shumë i shkurtër dhe i pamundur për tu plotësuar pasi sikurse shpjeguam në këtë

objekt prokurimi ka artikuj si tonerat, shtypshkrimet të cilët duhet të porositen tek prodhuesit e tyre ose të prodhohen dhe afati në dipozicion është shumë I shkurtër. Tonerat janë mallra importi dhe sigurisht që nisur nga këkresat e AK-së, OE-ve u lind nevoja që një pjesë të tonerave të cialt nuk I kanë gjendje në magazinat e tyre ti porositin tek prodhuesit apo distributorët e tyre për ti siguruar. Është në detyrimin e AK-së të respektojë dispozitat e këtij ligji dhe të akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij, të garantojë respektimin e parimeve të trajtimit të barabartë, transparencës, konkurrencës dhe mosdiskriminimit, të parashikuara rregullat e prokurimit publik.

Është përgjegjësia e AK-së të mirëplanifikojë në cilësi dhe në kohë fondet publike e nevojat e tij dhe të prokurojë e të zbatojë kontratën në përputhje me legjislacionin në fuqi. Ky afat kaq I shkurtër vjen në kundërshtim me parimet dhe qëllimin e ligjit të prokurimit public të përcaktura në nenin 2 dhe nenin 3 të LPP\_së:

Në nenin 2 (Qëllimi) të ligjit 162/2020 përcaktohet si vijon:

“Qëllim i këtij ligji është:

- a) të rrisë eficiency dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik;
- b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;
- c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;
- ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;
- d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik;
- dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.”

Në nenin 3 (Parime të përgjithshme) të ligjit 162/2020 përcaktohet si vijon:

“1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale.

2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar”.

Në Nenin 21 (Autoriteti ose enti kontraktor) të LPP-së, përcaktohet:

“? 1. Autoriteti ose enti kontraktor është përgjegjës për prokurimin në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe të akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij, duke garantuar respektimin e parimeve të trajtimit të barabartë, transparencës, konkurrencës dhe mosdiskriminimit, të parashikuara në këtë ligj. Në kuptim të kësaj pike, autoriteti ose enti kontraktor ka detyrimin të mirëplanifikojë në cilësi dhe në kohë fondet publike e nevojat e tij dhe të prokurojë e të zbatojë kontratën në përputhje me legjislacionin në fuqi?”

Në pikën 1 të nenit 77 “Kërkesat për kualifikim”, të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, I ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

“?Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar

kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës?”

Në pikt 1, 2 dhe 3 të Nenit 40 (Kërkesa të veçanta për kontratat e mallrave) të VKM 285/2021, e ndryshuar përcaktohet:

“1. Në procedurat e prokurimit për mallra, autoriteti/enti kontraktor parashikon sasinë e mallrave që do të lëvrojë, si dhe grafikun e lëvrimit të mallrave.

2. Për mallrat që do të prokurohen, autoritetet/entet kontraktore parashikojnë specififikimet teknike, të cilat duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, në përputhje me nenin 36, të LPP-së, dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara.

3. Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike, në përputhje me nenin 77, të LPP-së. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve?”

Në rastin konkret afati vetëm prej 7 ditëve nga lidhja e kontratës për të lëvruar të gjithë mallin objekt prokurimi është shumë i shkurtër, i paargumentuar nga AK-ja dhe jo në përprocion me objektin e prokurimit.

Komisioni i prokurimit Publik, në raste të tjera të ngjashme në lidhje me ankesa në të cilat ka pasur pretendime në lidhje me afate levrimi të shkurtra që ka mbajtur gjithmonë qëndrimin se, operatorëve ekonomikë duhet tu lihen afate levrimi të mjaftueshme për realizimin në kohë dhe me cilësi të objektit të prokurimit, duke pasur parasysh sasinë e konsiderueshme të mallit që do të lëvrohet, volumin dhe përmasat e kontratës objekt - ankimimi, ndaj afati i lëvrimit të mallit dhe për të siguruar në kohë mallin me karakteristikat dhe specififikimet e kërkuara në dokumentet e procedurës së prokurimit objekt-ankimi.

Konkretisht në Vendimin e KPP-së nr. Nr. 393/2024, datë 23.04.2024 është arsyetuar si më poshtë vijon:

“?III.1.7. Në rastin konkret, referuar pretendimit të ankimuesit, si dhe argumenteve të autoritetit kontraktor, rezulton, se autoriteti kontraktor ka përcaktuar në dokumentet e tenderit, që levrimi i mallit do të bëhet brenda 10 ditëve pas lidhjes së kontratës dhe më pas, në përgjigje të pretendimeve të ankimuesit, ka vendosur zgjatjen e këtij afati me 15 ditë.

Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se afati i lëvrimit 15 ditë nga lidhja e kontratës nuk është i mjaftueshëm për realizimin në kohë dhe me cilësi të objektit të prokurimit, duke pasur parasysh sasinë e konsiderueshme të mallit që do të lëvrohet, volumin dhe përmasat e kontratës objekt - ankimimi, ndaj afati i lëvrimit të mallit në rastin konkret, duhet të jetë më i gjatë, në mënyrë që ofertuesve t’ju lihet koha e nevojshme për të siguruar në kohë mallin me karakteristikat dhe specififikimet e kërkuara në dokumentet e procedurës së prokurimit objekt-ankimi. Për rrjedhojë autoriteti kontraktor duhet të bëjë modifikimin e afatit të lëvrimit të mallit në mënyrë të tillë që të nxisë pjesëmarrjen dhe konkurrencën e operatorëve ekonomikë, të stimulojnë pjesëmarrjen e biznesit të vogël dhe të mesëm, si dhe të sigurojnë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në këto procedura, për realizimin me sukses të kontratës?”

Për gjithë sa më ishpër kërkojmë që afti i lëvrimin të mallit të ndryshojë dhe të përcaktohet jo më pak se, 20(njëzetë) ditë nga lidhja e kontratës.

II. Në lidhje me specifikimet teknike të përcaktuara në shtojcën 5, (Formulari i Specifikimeve teknike) të DT-së e konkretisht për artikujt si më poshtë:

“...Nr.14 (Printer Samsung Xpress M20236)- 3 cope;

Nr.24 (Gome fshirese e bardhe me zatore): Game universale per fshirje lapsi dhe boje. Te jete e bere nga materiali gome e bute (jo PVC), e pershtatshme per te fshire dhe njollat me te theksuara te lapsit dhe bojes. Nuk duhet te lere shenja dhe grimca ne flete pas perdorimit.;

Nr.26 (Blloqe shenimi tavoline me ngjyra 500 flete me ngjites): Blloqe me ngjitje 75mm?5mm x 75mm?5mm me 50 flete me ngjyra te ndryshme. Letrat ngjites shërbejnë për të nxjerre në pah mesazhet e rëndësishme dhe ngjiten edhe mbi sipërfaqe të veshtira. Ato mend të perdoren për të shenuar lajmerime,shenime etj- 150 cope;

Nr. 27 (Blloqe shenimi leter stik me ngjitje 100 flete): Blloqe me ngjitje 75mm?5mm x 75mm?5mm me 50 flete me ngjyra te ndryshme. Letrat ngjites shërbejnë për të nxjerre në pah mesazhet e rëndësishme dhe ngjiten edhe mbi sipërfaqe të veshtira. Ato mend të perdoren për të shenuar lajmerime,shenime etj - 180cope;

Nr.35 (USB 16 GB): UPS- 70 cope;

Nr.47 (Kapse me vesh (binder clips) te medha 10cope/pako): Ndërtimi i produktit të jetë i fortë dhe i qëndrueshëm që lejon të kapen shumë faqe së bashku për organizimin përfundimtar të dokumentave. Paketimi jo më pak se 12 copë- 30 pako;

Nr.56 (Dosje konferenciale magnetike A5 zeze): Dosje konferenciale magnetike A5 zeze- 15 cope;

Nr. 69 (Flamur me thek (institucioni) 90x145 cm): Flamur me thek (institucioni) 90x145 cm-20 cope;..”, kërkojmë sqarimet dhe ndryshimet si më poshtë:

Për artikullin Nr.14 (Printer Samsung Xpress M20236), me sasi: 3 cope, lutemi verifikoni modelin për të cilin e kërkonit këtë toner. Nuk ka model M2036, mund të jetë bërë një lapsus ng ana juaj dhe qëllimi dhe kërkesa juaj është për modelin M2026?? Lutemi qartësimet tuaja në lidhje me këtë artikull.

Për artikullin Nr.24 (Gome fshirese e bardhe me zatore): Game universale per fshirje lapsi dhe boje. Te jete e bere nga materiali gome e bute (jo PVC), e pershtatshme per te fshire dhe njollat me te theksuara te lapsit dhe bojes. Nuk duhet te lere shenja dhe grimca ne flete pas perdorimit, lutemi sqarimin tuaj në lidhje me specifikimin teknik “..me zatore” pasi nuk e kuptojmë këtë term dhe kjo sjell rrjedhimisht vështirësi në përgatitjen e ofertës. Lutemi sqarimin tuaj me fjalë ose dhe publikoni një foto ilustruese të produktit si e kërkonit.

Për artikullin Nr.26 (Blloqe shenimi tavoline me ngjyra 500 flete me ngjites): Blloqe me ngjitje 75mm?5mm x 75mm?5mm me 50 flete me ngjyra te ndryshme. Letrat ngjites shërbejnë për të nxjerre në pah mesazhet e rëndësishme dhe ngjiten edhe mbi sipërfaqe të veshtira. Ato mend të

perdoren per te shenuar lajmerime,shenime etj- 150 cope. Lutemi percaktoni numrin e sakte te fleteve 50 apo 500 flete?;

Për artikullin Nr. 27 (Blloqe shenimi leter stik me ngjitje 100 flete): Blloqe me ngjitje 75mm?5mm x 75mm?5mm me 50 flete me ngjyra te ndryshme. Letrat ngjitese sherbejne per te nxjerre ne pah mesazhet e rendesishme dhe ngjiten edhe mbi siperfaqe te veshtira. Ato mend te perdoren per te shenuar lajmerime,shenime etj - 180cope; Lutemi, percaktoni numrin e saktë të fletëve blloqe me 50 fletë apo me 100 flete?

Për artikullin Nr.35 (USB 16 GB): UPS- 70 cope; Ju lutem na sqaroni nëse kërkoni USB apo UPS pasi janë dy artikuj krejtësisht të ndryshem nga njëri tjetri?

Për artikullin Nr.47 (Kapse me vesh (binder clips) te medha 10cope/pako): Ndërtimi i produktit të jetë i fortë dhe i qëndrueshëm që lejon të kapen shumë faqe së bashku për organizimin përfundimtar të dokumentave. Paketimi jo më pak se 12 copë- 30 pako; Lutemi percaktoni përmasën e saktë të kapseve me veshë si dhe saktësoni se sa copë duhet te përmbaje paketimi 10 apo 12 cope?

Për artikullin Nr.56 (Dosje konferenciale magnetike A5 zeze): Dosje konferenciale magnetike A5 zeze- 15 cope;

Lutem publikoni nje foto ilustruese të këtij produkti pasi nuk e kuptojmë se cfarë produkti kërkoni të prokuroni.

Për artikullin Nr. 69 (Flamur me thek (institucioni) 90x145 cm): Flamur me thek (institucioni) 90x145 cm-20 cope; Lutemi, korrigjoni përmasat e përcaktura për artikullin “Flamur me thek (institucioni)” pasi, përmasat standarte për këtë artikull, pra për flamurin standart janë ( 90 x 140) cm.

Në lidhje me specifikiemet teknike të tonerave ku ndër të tjera janë kërkuar:

“...2.Emri i kompanisë prodhuese duhet të jetë i stampuar dhe i njëjtë në paketim, cartridge (toner). Marka prodhuese të jetë në ambalazhin dhe/ose në trupin e tonerave, numrat serialë të tonerave duhet të korrespondojnë në të gjitha pjesët e trupit, në pako...

4.Në momentin e lëvrimin të mallit çdo produkt duhet të ketë të etiketuar qartë prodhuesin, modelin/numrin e printimeve/kodin e tonerit dhe nëse tonerat janë kompatibël duhet të kenë të shënuar mbi kuti që janë kompatibël për modelin e printerit..

5.Tonerat të kenë afat skadence jo më pak se një vit nga momenti i lëvrimin të mallit, (në momentin e dorëzimit të mallit tek autoritetit kontraktor, malli të shoqërohet me çertifikatën e garancisë).... paraqesim argumentat si mëposhtë:

Sikurse e kemi argumentuar edhe në shumë ankesa të tjera, ankesa të cilat janë pranuar nga KPP-ja, në lidhje me kërkesa të tilla si: mënyra e ambalazhimit apo se, cfarë të dhënash vendosen në ambalazh apo në trupin e produktit, në rastin konkret të tonerave, janë nje zgjedhje, një e drejtë dhe një vendimmarrje të cilën e ka vetem prodhuesi. Vendimi nëse në numrat serialë do të jenë ase jo në të gjitha pjesët e trupit, në pako?.. çdo produkt duhet të ketë të etiketuar qartë ..., /numrin e printimeve?”, nuk janë të dhëna të cilat janë në dorën e operatorit ekonomik ofertues pasi, është vetëm prodhuesi i tonerit i cili vendos se cfarë të dhënash vendos në në trupin e tonerit apo ambalazhin e tij apo cfarë lloje elementësh sigurie vendos në produktin e prodhuar prej tij.

Për sa kohë që nga AK-ja janë lejuar të ofertohej edhe me tonera kompatibël atëherë për këto lloj

tonerash, jo gjithmonë prodhuesit e tyre i vendosin të gjitha elementët kkruara nga AK-ja. Është kodi I produktit I cili të jep të psh numrin e printimeve që realizon ai toner edhe ndoshta ky numër nuk është përcaktuar në ammbalazhin e produktit.

Ne, si tregues të tonerave nuk mund të detyrojmë prodhuesit të vendosin të dhëna të tilla në paketim, tek etiketat apo në trupin e bojës. Prandaj këto kërkesa dalin jashtë kompetencave tona. Autoriteti juaj kontraktor nuk mund të vendosë një kërkesë apo të vlerësojë një ofertues për kritere që nuk janë as kompetence, as e drejte e tij si OE. Për më tepër që këto elemente, nuk janë nga ato elemente të cilët përcaktohen si të detyrueshem nga ndonjë standart i aprovuar cilesie, në mënyrë që të garantojë cilësi të produktit. Këto elemente, nuk ndikojnë në cilësinë apo në funksionalitetin e tonerit dhe për pasojë prezenca apo mungesa e tyre, sic kërkohet nga ana juaj, nuk jep asnjë garanci që produkti do të jetë me funksional apo me cilesor.

Një kërkesë e tillë sjell kufizim dhe përjashtim nga pjesmarrja në tender, pasi operatorët ekonomikë përjashtohen në mënyrë të padrejtë nga pjesmarrja në këtë tender vetëm nga fakti se prodhuesi I tonerit nuk ka përcaktuar pikërisht psh numrat serial të produktit, numrin e printimeve etj?

Synimi I AK-së është të sigurojë tonera të cilët janë cilësore dhe përshtaten me pajisjet dhe fakti nëse, janë vendosur ose jo numrat seriale në tonera nuk sjell asgjë të re përsa i përket cilësisë së produktit, pra të tonerit.

Në zbatim të nenit 21 të LPP-së, autoriteti kontraktor është përgjegjës për prokurimin në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe të akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij, duke garantuar respektimin e parimeve të trajtimit të barabartë, transparencës, konkurrencës dhe mosdiskriminimit, të parashikuara në këtë ligj.

Në nenin 36 (Specifikimet teknike) të LPP-së, ligjvënësi ka përcaktuar në mënyrë të qartë elementët të cilët duhet të pasqyrohen në specifikimet teknike të objektit të prokurimit, dhe që është në detyrimin e autoritetit kontraktor që në hartimin e specifikimeve teknike të mundësojnë trajtim të barabartë për të gjithë kandidatët dhe ofertuesit dhe të mos shërbejnë si pengesa për konkurrencën e hapur në prokurimin publik.

Kërkesa të tilla, për pasojë kjo kërkesë, penalizon në mënyrë të paligjshme pjesmarrjen e operatorë ekonomikë pasi, pamundëson pjesmarrjen e tyre në procedurën e prokurimit, pra sjell një trajtim të pabarabartë për të gjithë ofertuesit dhe shërben si pengesë për konkurrencën e hapur në prokurimin public, pasi favorizon vetëm ata prodhues të cilët e aplikojnë vendosjen e këtyre të dhënave në paketimet e produkteve.

Pasi, në mënyrë se si janë kërkuar nga ana juaj, përjashtohet një numër I konsiderueshem prodhuesish, të cilët kanë standartet e tyre të ambalazhimit, të ndryshme nga kërkesat e përcaktuara nga ju, por gjithnjë, duke plotësuar të gjitha kërkesat dhe standartet e cilësisë.

Ka një standart/ qëndrim të vendosur tashmë nga KPP-ja në lidhje me kërkesa të tilla si: mënyra e ambalazhimit apo se, çfarë të dhënash vendosen në ambalazh apo në trupin e produktit, në rastin konkret të tonerave dhe qëndrimi është se, këto elemente janë një zgjedhje, një e drejtë dhe një vendimmarrje të cilën e ka vetëm prodhuesi.

**Konkretisht:**

Komisioni I Prokurimit Publik së fundmi me vendimin e tij Nr. 563/2023, datë 05.07.2023, pas shqyrtimit të një ankesë e cila kishte për objekt edhe kundërshtimin e pullave të sigurisë në

ambalazhin e produktit, ka arsyetuar si më poshtë vijon:”?. Sa më sipër në interpretim të nenit 44 pika 2, të VKM 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, KPP gjykon se me anë të kërkesës së mësipërme, autoritetit kontraktor kërkon nga ana e operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dokumentacion provues në të cilin të jenë lehtësisht të verifikueshme të dhënat teknike të produkteve të ofruara të dhëna që lidhen me emrin e produktit, markën prodhuese, pullën e sigurisë, specifikimet teknike të kërkuara, treguesit fiziko kimik të cilat në thelb vërtetojnë përputhshmërinë e tyre me kërkesat e autoritetit kontraktor mbi mallin. Në rastin konkret autoriteti kontraktor ka kërkuar që etiketa me elementët përkatëse të jetë e stampuar mbi ambalazhin e produktit. Me të drejtë ankimesit kundërshtojnë këtë kërkesë, pasi mënyra si pasqyrohen të dhënat e produktit, sikundër kërkuar në kriterin e veçantë të kualifikimit, është në diskrecion të vetë prodhuesit dhe jo të ofertuesve pjesëmarrës në procedurë. Kërkesa që etiketa të jetë në ambalazhin e produktit, kufizon ata prodhues që elementët e kërkuar lidhur me produktin mund t'i kenë të pasqyruara në trupin e produktit dhe jo domosdoshmërisht në 11 ambalazhin e tyre. Akoma më tej edhe vetë autoriteti kontraktor në kthim-përgjigjen drejtuar ankimesve ka pranuar, se vendosja mbi kuti apo mbi produkt nuk është kusht skualifikues, pasi qëllimi përfundimtar i këtij kriteri është njohja e të dhënave të produktit, por në përfundim ka vendosur mospranimin e kërkesës së ankimesve për modifikimin e kriterit. Në këto kushte, Komisioni gjykon, se autoriteti kontraktor duhet të modifikojë kërkesën që tonerat të jenë të pajisur me pullë sigurie, duke lënë të hapur mundësinë e vendosjes së pullës së sigurisë, pasi pajisja e tonerave me pulla sigurie nuk varet nga ofertuesit por nga prodhuesit të cilët jo të gjithë e kanë politikë të tyre pajisjen e tonerave me pulla sigurie, fakt i cili pranohet dhe nga ana e autoritetit kontraktor në kthimin e përgjigjes. Modifikimi i kërkesës së mësipërme objekt-shqyrtimi është i nevojshëm, pasi në rastin konkret Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se kërkesa e mësipërme nuk është e përshtatshme për arritjen e synimit të autoritetit kontraktor, për verifikimin e përputhshmërisë së produkteve, kjo pasi plotësimi i kërkesës së mësipërme nuk varet nga vullneti i operatorëve ekonomikë pjesëmarrës për hartimin dhe dorëzimin e ofertave teknike në përputhje me kërkesën e autoritetit kontraktor. Gjithashtu, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se kërkesa e mësipërme e autoritetit kontraktor nuk është proporcionale me objektin e procedurës së prokurimit, natyrën, përmasat e kontratës si edhe me qëllimin e kërkuar nga vetë autoriteti kontraktor. Sa më sipër pretendimi i ankimesit qëndron.”?

Në vendimin e KPP-së, Nr. 769/2023, datë 16.08.2023, Komisioni i Prokurimit Publik në një rast tjetër të ngjashëm ka arsyetuar si më poshtë:

“?III.6.3. Referuar ankesës së operatorit ekonomik në lidhje me pikën 3, Emri i kompanisë prodhuese duhet të jetë i stampuar dhe i njëjtë në paketim, cartridge (toner) dhe të ketë 16

pullën e sigurisë. Marka prodhuese të jetë në ambalazhin dhe në trupin e tonerave, numrat serialë të tonerave duhet të korrespondojnë në të gjitha pjesët e trupit, në pako. ku kundërshton kërkesën në lidhje me vendosjen e numrave serialë, Ankimesi argumenton qartë pretendimet e tij si kërkesë të ekzagjeruar.

Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se kërkesa e mësipërme është e tepërt dhe konfuze ndaj ankimesi me të drejtë kundërshton specifikimin e sipërcituar i cili më shumë se sqarues është konfuz me kërkesa të tepruara. Është e rëndësishme që tonerat të kenë paketime të pahapura dhe të japin informacion të plotë të të gjitha të dhënave të tonerit si në paketime, kuti siç vetë prodhuesit vendosin për produktet e tyre. Kërkesa të përsëritur dhe të tepërta bëhen pengesë për operatorët ekonomikë ofertues të mundshëm për një konkurrencë të hapur e të gjerë, bazuar kjo në përcaktimet e legjislacionit për prokurimin publik.

Sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon se autoriteti kontraktor si organi përgjegjës për procedurën e prokurimit ka detyrë të mirëargumentojë bindshëm vendosjen e specifikimeve teknike me specifikime të qarta dhe kërkesa për kualifikim për artikujt e kërkuar të jenë në proporcion me fondin limit, sasinë e kërkuar apo edhe natyrën e procedurës objekt shqyrtimi, në

funksion të realizimit me sukses të kontratës.

Komisioni gjithashtu sjell në vëmendje se, referuar rregullave të prokurimit publik, përgjegjësinë thelbësore për realizimin e suksesshëm të kontratës nga autoriteti kontraktor, i cili ndjek realizimin e kontratës dhe verifikimin e mallit duke aplikuar sanksione në rast mosrealizimit të kontratës.

Komisioni gjykon se autoriteti kontraktor duhet të modifikojë kërkesat objekt ankimi duke shtuar termin në rastet kur aplikohet nga prodhuesi, me qëllim për të hapur konkurrencën me pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë të mesëm dhe të vegjël.

Përsa referuar më sipër pretendimet e ankimuesit qëndrojnë?”

Në vendimet e saj KPP-ja shpesh e ka vënë në dukje faktin se, vetë ligjvënësi ka parashikuar në nenin 2 gërma “dh” të Ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” se qëllimi i ligjit të prokurimit publik si ligj material i zbatueshëm për shqyrtimin administrativ të ankesave të operatorëve ekonomikë, është ndër të tjera të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik. Ashtu si edhe GJED ka nënvizuar ndër vite, parimi i transparencës dhe barazisë janë të lidhura ngushtë me njëra-tjetrën, por detyra thelbësore e transparencës në një procedurë prokurimi është që të krijohen kushte dhe rregulla të hollësishme për të gjitha palët në proces. Autoriteti kontraktor është organi përgjegjës për procedurën e prokurimit dhe është përgjegjësi e tij të përcaktojë kriteret që janë në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

Rrjedhimisht autoriteti kontraktor është në të drejtën e tij për të përcaktuar kriteret dhe specifikime teknike në lidhje me produktet e kërkuara, por pa përcaktuar kërkesa të cilat krijojnë konfuzion apo që nuk ndikojnë në performancën e produktit, pasi përcaktimet të tilla janë diskriminuese dhe përjashtuese nga pjesëmarrja në procedurë të operatorëve ekonomikë të interesuar.

GJYKUAR SA ME SIPER, KËRKOJMË që në kërkesat e AK-së

...“...2.Emri i kompanisë prodhuese duhet të jetë i stampuar dhe i njëjtë në paketim, cartridge (toner). Marka prodhuese të jetë në ambalazhin dhe/ose në trupin e tonerave, numrat serialë të tonerave duhet të korrespondojnë në të gjitha pjesët e trupit, në pako...

4.Në momentin e lëvrimit të mallit çdo produkt duhet të ketë të etiketuar qartë prodhuesin, modelin/numrin e printimeve/kodin e tonerit dhe nëse tonerat janë kompatibël duhet të kenë të shënuar mbi kuti që janë kompatibël për modelin e printerit.....” të shtohet edhe togfjalëshi “?në rastet dhe në mënyrën sic aplikohet nga prodhuesi”

Në lidhje me kërkesën e AK-së:

“...5.Tonerat të kenë afat skadence jo më pak se një vit nga momenti i lëvrimit të mallit, (në momentin e dorëzimit të mallit tek autoritetit kontraktor, malli të shoqërohet me çertifikatën e garancisë)...” paraqesim pretendimet tona simë poshtë:

Vendosja e afatit të skadencës ka vlerë vetëm për tonerat e lëngshëm pra, tonerat ”lazer jet”, pasi tonerat pluhur nuk kanë afat skadence, pra nuk skadojnë.

Në këto kushte kërkojmë që, kërkesa e më sipërme të formulohet si më poshtë:

“...5.Tonerat e lëngshëm (lazer jet) të kenë afat skadence jo më pak se një vit nga momenti i lëvrimit të mallit, (në momentin e dorëzimit të mallit tek autoritetit kontraktor, malli të shoqërohet me deklaratën e garancisë)...”

Dorëzimi i deklaratës së garancisë nga ofertuesi, garanton autoritetit kontraktor se në cdo rast në rast se tonerat e lëngshëm skadojnë përpara afatit një vjeçar të tyre, atëherë OE do të bëjë

zëvendësimin e këtij toneri më një tjetër brenda afatit të garancisë së kërkuar.

Specifikimet teknike për artikujt e cituar më sipër, duhet të sqarohen, të plotësohen dhe të saktësohen për ti sjellë ato në përputhje të plotë me ligjin, rregullat e prokurimit public si dhe me vendimet e KPP-së të cilat kanë vendosur një standart për mënyrën se si AK-të duhet të hartojnë specifikimet teknike të artikujve e konkretisht:

Në pikën 38 të nenit 4 të ligjit 162/2020 përcakton përkufizimin e specifikimeve teknike e konkretisht:

“... 38. “Specifikime teknike” janë:

b) në rast të prokurimit publik të mallrave ose shërbimeve, specifikimi me të cilin përkufizohen karakteristikat e prodhimit ose shërbimit, siç janë niveli i cilësisë, ndikimi mbi mjedisin jetësor dhe ndikimet klimatike, përshkrim i të gjitha kushteve, duke përfshirë edhe arritshmëri për persona me aftësi të kufizuara dhe vlerësim të përputhshmërisë, niveli i realizimit, shfrytëzim i prodhimit, siguri ose dimensione, duke i përfshirë edhe kërkesat relevante për produktin në raport me emërtimin me të cilin shitet, terminologjinë, simbolet, testimet dhe metodat për testim, paketimin, shënimin dhe etiketimin, si dhe udhëzime për përdorim, proceset dhe metodat e prodhimit në secilën fazë të jetëgjatësisë së mallrave dhe shërbimeve, si dhe procedura për vlerësim të përputhshmërisë?”.

Në Nenin 36 (Specifikimet teknike) të LPP-së përcaktohet:

“3. Specifikimet teknike duhet të përshkruajnë qartë kërkesat e autoritetit ose entit kontraktor, duke iu referuar:

a) kërkesave funksionale ose të performancës, përfshirë karakteristikat mjedisore, me kusht që parametrat të jenë të saktë në mënyrë që t’u japin mundësi ofertuesve të përcaktojnë objektin e kontratës dhe autoriteteve ose enteve kontraktore të japin kontratën;

b) standardeve kombëtare, që mbështeten në ato ndërkombëtare, miratimeve teknike ndërkombëtare, specifikimeve teknike të përgjithshme, standardeve ndërkombëtare apo sistemeve të tjera teknike të referimit, të përcaktuara nga organet ndërkombëtare të standardizimit. Kur këto nuk ekzistojnë, ato u referohen standardeve kombëtare, miratimeve teknike kombëtare ose specifikimeve teknike kombëtare, që lidhen me projektimin, përlllogaritjen dhe ekzekutimin e punëve ose përdorimin e produkteve;

c) kërkesave në terma funksionalë sipas shkronjës “a”, referuar specifikimeve teknike sipas shkronjës “b” të kësaj pike, si mënyrë që nënkupton pajtueshmëri me kërkesat funksionale;

ç) të dyja metodave të përcaktuara në shkronjat “a” dhe “b” të pikës 3 të këtij neni, për mallra, shërbime ose punë të ndryshme, të përfshira në të njëjtin objekt kontrate. Çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.

4. Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të këtij neni. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

5. Në rast se autoriteti ose enti kontraktor përcakton specifikimet teknike në bazë të shkronjës “b” të pikës 3 të këtij neni, nuk mund të refuzojë një ofertë me argumentin se punët, furnizimet apo shërbimet për të cilat është dorëzuar oferta nuk plotësojnë specifikimet teknike, të cilave u referohen, për sa kohë që ofertuesi provon në ofertën e tij me ?do mjet të përshtatshëm që zgjidhjet e propozuara përmbushin kërkesat e përcaktuara në specifikimet teknike në mënyrë ekuivalente.

6. Në rast se autoriteti ose enti kontraktor përcakton specifikimet teknike në bazë të shkronjës “a”

të pikës 3 të këtij neni, ai nuk mund të refuzojë një ofertë për punë, mallra apo shërbime, e cila është në përputhje me standardet kombëtare, që mbështeten në ato ndërkombëtare, miratimet teknike ndërkombëtare, specifikimet teknike të përgjithshme, standardet ndërkombëtare apo sistemet e tjera teknike të referimit, të përcaktuara nga organet ndërkombëtare të standardizimit kur këto specifikime teknike përmbushin kriteret funksionale, të përcaktuara nga autoriteti/enti kontraktor., ?”

Duke u ndalur ne piken 3 te nenit 36 te ligjit per prokurimin publik, gjykojme se, ligjvenesit ka parashikuar kater metoda kryesore ne hartimin e specifikimeve teknike.

Metoda e pare lidhet me kerkesat funksionale ose te performances, perfshire karakteristikat mjedisore, me kusht qe parametrat te jene te sakte ne menyre qe t'u japin munde si ofertuesve te percaktojne objektin e kontrates dhe autoriteteve ose enteve kontraktore te japin kontraten.

Metoda e dyte mbeshtet ne standardet kombetare, qe mbeshteten ne ato nderkombetare, miratimeve teknike nderkombetare, specifikimeve teknike te pergjithshme, standardeve nderkombetare apo sistemeve te tjera teknike te referimit, te percaktuara nga organet nderkombetare te standardizimit. Kur keto nuk ekzistojne, ato u referohen standardeve kombetare, miratimeve teknike kombetare ose specifikimeve teknike kombetare, qe lidhen me projektimin, perllogaritjen dhe ekzekutimin e puneve ose perdorimin e produkteve.

Metoda e trete perfshin kerkesat ne termat funksional sipas metodes se pare, por referuar specifikimeve teknike te hartuara sipas metodes se dyte, si nje menyre qe nenkupton pajtuesmeri me kerkesat funksionale,

Metoda e katër përfshin të dy metodat e përcaktuara ne shkronjat a dhe b te pikës 3 te nenit 36 te ligjit per prokurimin publik, per mallra, shërbime ose punëve të ndryshme, te perfshira ne te njejtin objekt kontrate. ?cdo referenc duhet te shoqerohet nga fjalet ose ekuivalenti i tij/saj.

Nga interpretimi teleologjik (qellimi i normes juridike), arrijme ne perfundim, se e rendesishme eshte qe permes specifikimeve teknike, autoriteti kontraktor te mundesoje nje konkurrim te drejte, te hapur, e gjithepershires, te barabarte dhe jo diskriminues per te gjithë operatorët ekonomike, si edhe te mos drejtohen drejt nje produkti te vetem te ofruar nga nje operator i vetem ose nga nje numer i kufizuar operatorësh.

Në pikën 2 të nenit 40 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, parashikon shprehimisht se: “Për mallrat që do të prokurohen, autoritetet/entet kontraktore parashikojnë specifikimet teknike, të cilat duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, në përputhje me nenin 36, të LPP-së, dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara”.

Referuar legjisllacionit publik por edhe në qëndrimet dhe vendimet e Komisionit të Prokurimit Publik është qartësisht e përcaktuar se, autoriteti kontraktor është organi përgjegjës për procedurën e prokurimit dhe ka për detyrë të mirë argumentojë vendosjen e parametrave për produkteve të kërkuara (pra të argumentojë hartimin e specifikimeve teknike) në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

Për gjithë sa më sipër kërkojmë dhënien e sqarimeve si dhe pranimin e pretendimeve tona sic i kemi shpjeguar për cdo artikull më sipër.

III. Në lidhje me kriterin për kualifikim të përcaktuar në shtojcën 7(Formulari i kriterëve të përzgjedhjes/kualifikimit), të DT-së, tek Kriteret e vecanta të kualifikimit, tek pika 2.3.3 dhe 2.3.4 më përmbajtjen si më poshtë:

?2.3.3 Operatori ekonomik ofertues për mallrat objekt prokurimi duhet të paraqesë katalogun/et

ose fragmente të katalogut/eve ose skedat teknike të mallrave objekt prokurimi, me qëllim vërtetimin e përmbushjes së specifikimeve teknike. Katalogu ose skeda teknike duhet të përmbajë karakteristikat teknike të çdo artikulli sipas kërkesave të DST me qëllim që autoriteti kontraktor të gjykojë nëse malli i ofruar plotëson kërkesat teknike të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Për produktet e thjeshta për të cilat nuk mund të sigurohen katalogë ose skeda teknike mjafton të paraqiten mostrat sipas parashikimeve në pikën 2.3.4 dhe ky kriter do të konsiderohet i përmbushur;

2.3.4 Për artikujt e ofertuar (bojerat e printerit) duhet të paraqiten mostrat origjinale/ekuivalente, sipas specifikimeve teknike në datën dhe orën e hapjes së ofertave.

Mosdorëzimi i këtyre mostrave në kohë përbën shkak për skualifikimin e operatorit ekonomik ofertues...” parashtojme kundërshtimet tona si më poshtë:

Së pari:

Në procese verbale të hartimit të dokumentave kriteret e mësipërme janë argumentuar respektivisht si më poshtë vijojnë:

“...Argumentimi: Ky kriter është menduar për ti dhënë sigurinë AK që OE ofertues do të paraqesë mallra, të cilët përmbushin kërkesat e specifikimeve teknike dhe janë në përputhje me to. Kriteri i kërkuar në lidhje me katalogun e prodhuesit/prodhuesve, është vendosur në përputhje me piken 6/b, të Nenit 40, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”...

... Ky kriter është menduar për ti dhënë sigurinë AK që OE ofertues do të paraqesë mallra, të cilët përmbushin kërkesat e specifikimeve teknike. Kriteri i kërkuar në lidhje me deklaratën, është vendosur në përputhje me piken 6/b, të Nenit 40, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”...”

Kërkesat e mësipërme janë të ekzagjerura dhe jo në përputhje dhe në proporcion me vlerën dhe objektin e prokurimit.

AK-ja ka kërkuar mostra për të gjithë artikujt tonera dhe katalogë apo skeda teknike për të gjithë artiujt e tjerë të kancelarisë apo të shtypshkrimeve dhe kjo është një kërkesë e ekzagjruar pasi në total janë 69 lloje artikuj kancelarisë, 6 llojeve të shtypshkrimeve dhe 21 llojet e tonerave të cilat një pjesë e madhe e tyre janë kërkuar në sasi të vogla. E konkretisht:

Në rastin e tonerave për të gjitha llojet e kërkuara për tu prokuruar sasi të për secilën prej tyre janë më pak se 9 copë dhe pjesa më e madhe e tyre janë kërkuar në sasi deri në 5 copë. Është ekzagjruar të kërkosh mostra për tonera të cilat janë kërkuar 1, apo 2, 3, 4 apo edhe 5 copë.

Gjithashtu AK-ja kërkon që, operatori ekonomik ofertues për të gjithë mallrat objekt prokurimi të paraqesë katalogun/et ose fragmente të katalogut/eve ose skedat teknike të mallrave objekt prokurimi, me qëllim vërtetimin e përmbushjes së specifikimeve teknike. Katalogu ose skeda teknike duhet të përmbajë karakteristikat teknike të çdo artikulli sipas kërkesave të DST me qëllim që autoriteti kontraktor të gjykojë nëse malli i ofruar plotëson kërkesat teknike të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Për produktet e thjeshta për të cilat nuk mund të sigurohen katalogë ose skeda teknike mjafton të paraqiten mostrat sipas parashikimeve në pikën 2.3.4 dhe ky kriter do të konsiderohet i përmbushur.

Pra, sipas kriterit si më sipër kërkohet që OE-të ose të paraqesin katalogë apo skeda teknike, ose për artikujt e thjeshtë për të cilët nuk mund të sigurohen katalogë ose skeda teknike mjafton të paraqiten mostrat sipas parashikimeve në pikën 2.3.4 dhe ky kriter do të konsiderohet i përmbushur, pra sërish kërkohen mostra për artikuj të cilët janë kërkuar në sasi të vogla dhe që

janë artikuj të thjeshtë kancelarie.

Ng ana tjetër ky kriter lë vend për interpretime të ndryshme nga KVO-ja në rastin e vlerësimit se për cilët artikuj do të vlerësohet “të thjeshtë” dhe për të cilët nuk mund të sigurohen katalogë ose skeda teknike dhe për ta mjaftton të dorëzohen mostra.

Të nderuar kjo procedurë prokurimi është e hapur e thjeshtuar dhe me vlerë totale të fondit limit 1,620,870.30 (një milion gjashtëqind e njëzet mijë e tetëqind e shtatëdhjetë pikë tridhjetë) lekë pa TVSH dhe për procedura të tilla ligjvënësi ka përcaktuar se duhet të vendosen kritere të thjeshtuara pranimi me qëllim që të nxitet pjesmarrja e biznesit të vogël dhe të mesëm

Në pikën 4 të Nenit 55 (Procedurë e hapur e thjeshtuar) të VKM 285/2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit public” e ndryshuar, përcaktohet:

“4. Në këtë lloj procedure prokurimi, autoritetet kontraktore duhet të mbajnë në konsideratë të përcaktojnë kritere të thjeshtuara pranimi, me qëllim nxitjen e pjesëmarrjes së biznesit të vogël dhe të mesëm?”

Në pikën 1 të nenit 77 (Kërkesat për kualifikim) të LPP-së përcaktohet:

“1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës?”

Të njëjtin qëndrim ka mbajtur edhe KPP-ja në shumë vendime të saj, në rastet kur ka pasur pretendime nga OE-të në lidhje me kërkesën e AK-ve për të dorëzuar katalogë apo mostra për të gjitha artikujt e kërkuar.

Konkretisht së fundmi në vendimin e tij Nr. 613/2024, datë 04.06.2024, Komisioni I Prokurimit Publik ka arsyetuar:

[?] Referuar pretendimeve të operatorit ekonomik ankimues të paraqitura në ankesë, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se është me vend të ndalet në faktin nëse kërkesa për paraqitjen e mostrave për secilin prej artikujve është në proporcion me objektin e kontratës që do të prokurohet në zbatim të nenit 77 pika 1 të LPP-së. Në rastin konkret KPP konstaton, se synimi bazë i autoritetit kontraktor është vërtetimi se subjektet ofertues zotërojnë kapacitetet e nevojshme për realizimin e kontratës. KPP konstaton, se për përmbushjen e këtij synimi, autoriteti kontraktor ka parashikuar në dokumentet e procedurës së prokurimit jo vetëm kritere kualifikimi të cilat lidhen me vërtetimin e kapacitetit teknik, por edhe kritere të tjera kualifikimi të cilat lidhen me vërtetimin e plotësimin të specifikimeve teknike të produktit me anë të dorëzimit të mostrave. Në këto kushte, KPP gjykon, se kërkesa e mësipërme e autoritetit kontraktor mbi dorëzimin e mostrave është në përputhje me nenin 40, pika 6 gërma “a” të Vendimit të Këshillit të 22 Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, por kërkesa për dorëzimin e mostrave për të gjithë artikujt e kërkuar në shtojcën e ngarkuar nga autoriteti kontraktor me titullin “preventiv pa çmime” është një kërkesë e ekzagjeruar dhe shkon përtej asaj se çfarë është e nevojshme për realizimin e synimit.

Komisioni gjykon, se është e mjaftueshme që operatorët ekonomikë pjesëmarrës të paraqesin

vetëm nga një ekzemplar (mostër) për produktet që do të prokurohen, më përdorim më të lartë për institucionin, me qëllim verifikimin e përputhshmërisë së specifikimeve teknike të tyre me specifikimet teknike të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Për këtë arsye, autoriteti kontraktor duhet të bëjë modifikimin e dokumenteve të tenderit sipas konstatimeve të mësipërme.

Akoma me tej, Komisioni i Prokurimit Publik konstaton, se për përmbushjen e këtij synimi, autoriteti kontraktor ka parashikuar në dokumentet e procedurës së prokurimit, kritere të tjera kualifikimi të cilat lidhen plotësimin e specifikimeve teknike të produktit, siç është kërkesa për katalog.

Sa më sipër, pretendimet e operatoreve ekonomik ankimes “Interlogictic” SHPK dhe “Infosoft office” SHPK qëndrojnë [?].

Për sa më sipër, kërkojmë që kriteret për kualifikim të përcaktuara në shtojcën 7 (Formulari i kriterëve të përzgjedhjes/kualifikimit), të DT-së, tek Kriteret e vecanta të kualifikimit, tek pika 2.3.3 dhe 2.3.4 më përmbajtjen si më poshtë:

2.3.3 Operatori ekonomik ofertues për mallrat objekt prokurimi duhet të paraqesë katalogun/et ose fragmente të katalogut/eve ose skedat teknike të mallrave objekt prokurimi, me qëllim vërtetimin e përmbushjes së specifikimeve teknike. Katalogu ose skeda teknike duhet të përmbajë karakteristikat teknike të çdo artikulli sipas kërkesave të DST me qëllim që autoriteti kontraktor të gjykojë nëse malli i ofruar plotëson kërkesat teknike të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Për produktet e thjeshta për të cilat nuk mund të sigurohen katalogë ose skeda teknike mjafton të paraqiten mostrat sipas parashikimeve në pikën 2.3.4 dhe ky kriter do të konsiderohet i përmbushur;

2.3.4 Për artikujt e ofertuar (bojerat e printerit) duhet të paraqiten mostrat origjinale/ekuivalente, sipas specifikimeve teknike në datën dhe orën e hapjes së ofertave.

Mosdorëzimi i këtyre mostrave në kohë përbën shkak për skualifikimin e operatorit ekonomik ofertues...”, të ndryshojnë e të bëhen si më poshtë vijojnë:

2.3.3 Operatori ekonomik ofertues për mallrat objekt prokurimi të cilat janë me përdorim më të lartë në institucion, artikujt e kancelarisë të kërkuar nga AK-ja, në sasi të barabartë ose më lartë se 500 copë duhet të paraqesë katalogun/et ose fragmente të katalogut/eve ose skedat teknike të mallrave ose mostra të tyre, me qëllim vërtetimin e përmbushjes së specifikimeve teknike. Katalogu ose skeda teknike ose mostra duhet të përmbajë karakteristikat teknike të çdo artikulli sipas kërkesave të DST me qëllim që autoriteti kontraktor të gjykojë nëse malli i ofruar plotëson kërkesat teknike të përcaktuara në dokumentet e tenderit.

2.3.4 Për artikujt e ofertuar (bojerat e printerit) të kërkuara nga AK-ja në sasi mbi 5 copë, duhet të paraqiten mostrat origjinale/ekuivalente, sipas specifikimeve teknike në datën dhe orën e hapjes së ofertave.

Mosdorëzimi i këtyre mostrave në kohë përbën shkak për skualifikimin e operatorit ekonomik ofertues...”,

Të nderuar,

Në nenin 2 (Qëllimi) të ligjit 162/2020 përcaktohet si vijon:

“Qëllim i këtij ligji është:

- a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik;
- b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;
- c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;
- ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;
- d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik;
- dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.”

Në nenin 3 (Parime të përgjithshme) të ligjit 162/2020 përcaktohet si vijon:

- “1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale.
2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar”.

Pretendimet dhe kërkesat tona janë në përputhje të plotë me qëllimin e ligjit dhe me parimet e përcaktuara më sipër në legjislacionin e prokurimit publik dhe për më tepër nxitin dhe rrisin numrin dhe pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit public, duke sjellë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë.

**5. Kërkesë për ekspertizë të posaçme**

Po

Jo

*(Nëse po, specifikoni llojin e ekspertizës që kërkonte)*

---

**6. Kërkesë për përjashtim të zyrtarëve që do të merren me shqyrtimin e ankesës:**

JO

---

**7. Lista e informacionit konfidencial:**

JO

---

*Përcaktoni se cili informacion është konfidencial, nëse ka. Shpjegoni pse informacioni është ose një version i dokumenteve përkatëse me heqjen e pjesëve konfidenciale dhe një përmbledhje të përmbajtjes.*

***Kujdes: Ankimesi duhet t'i bashkëlidhë ankimit, që do të paraqesë në autoritetin/entin kontraktor dhe Komisionin e Prokurimit Publik, dokumentin bankar që vërteton pagesën e tarifës përkatëse për ankesën pranë Komisionit të Prokurimit Publik***

---

Dërgojeni formularin e plotësuar të ankesës së prokurimit, të gjitha shtojcat e nevojshme dhe kopjet shtesë, pranë **Autoritetit/Enti Kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik**.

Shënim: Ankimesi duhet ta dërgojë njëkohësisht ankesën në autoritetin/entin kontraktor dhe Komisionin e Prokurimit publik

**Nr. i faksit:**

**E-mail:**

hr@infosoftoffice.al

**Nënshkrimi dhe vula e Ankuesit**

**Administratori/Përfaqësuesi i autorizuar**

Frederik Prodani